



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave  
Regulativni Autoritet Železnica  
Railway Regulatory Authority



Në bazë të nenit 38, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, Bordi i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave miraton:

REPUBLIKA E KOSOVËS   REPUBLIKA KOSOVO   REPUBLIC OF KOSOVO	
AUTORITETI RREGULLATIV I HEKURUDHAVE REGULATIVNI AUTORITET ŽELEZNICA RAILWAY REGULATORY AUTHORITY	
DEP/SEK. DEP/SEK: DEP/SEK:	NR PROT. BR. PROT. NR. PROT.
ARH	482
NUMRI I FAQEVE BRJ STRANA NR OF PAGES	DD.MM.VVVV: DD.MM.GGGG: DD.MM.YYYY:
4	17/01/2013
PRISHTINË / A	

**Rregullore për Ekspozeun e Rrjetit Nr. 01/2013**

Rr. Rrustem Statovci nr.29  
Prishtinë, Kosovë  
Tel:+381 38 22 00 40  
Fax:+381 38 22 33 40  
Web:www.arh-ks.org

Kuvendi i Kosovës  
Skupština Kosova  
Assembly of Kosovo

## **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i Rregullores është vendosja e rregullave dhe procedurave në lidhje me përmbajtjen e detyrueshme, procesin e konsultimit dhe publikimin e deklaratës së rrjetit në një mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese.

## **Neni 2 Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për të gjitha palët e interesit ekzistuese dhe ato të ardhshme.

## **Neni 3 Palët e Interesit**

Palët e interesit janë:

1. Çdo menaxher i licencuar i infrastrukturës hekurudhore në përdorimit të përbashkët, që është përgjegjëse për përgatitjen e Deklaratës së rrjetit.
2. Çdo Ndërmarrje Hekurudhore e Licencuar.
3. Çdo aplikant në kuptimin e Nenit. 3 "Përkufizime" të ligjit hekurudhor në fuqi.
4. Ministria përgjegjëse për çështjet hekurudhore, si autoriteti që miraton strukturën e sistemit të tarifimit dhe nivelin e përgjithshëm të tarifave të përdoruesve në kuptimin e Nenit 61, paragrafi 3 i Ligjit hekurudhor në fuqi.
5. Ministria përgjegjëse e Ndërmarrjeve në pronësi publike si aksionare e ndërmarrjeve shtetërore të transportit.
6. Autoriteti Rregullativ Hekurudhor si organ përgjegjës për rregullimin e tregut.

## **Neni 4 Pregaditja e Ekspozeut të Rrjetit**

1. Menaxherit të infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët i kërkohet për të përgatitur deklaratën e rrjetit.

2. Pavarësisht nga parimet e përcaktuara në legjislacionin e BE-së dhe struktura propozuar nga Rrjeti hekurudhor (RailNet) Evropë (RNE) Deklarata e rrjetit duhet të përfshijë përmbajtjen e mëposhtme:

2.1 Informacion të përgjithshëm për menaxherin e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët, duke përfshirë qëllimin, bazën ligjore, përgjegjësinë, procedurat ankimore, strukturën e deklaratës së rrjetit, vlefshmërinë, përditësimin, publikimin, kontakte kryesore dhe përkufizimit të termave.

2.2 Kushtet të cilat ndërmarrjet hekurudhore dhe aplikantët duhet të plotësojnë për qasje në infrastrukturë, duke përfshirë informacion në lidhje me marrëveshjet dhe kontratat për qasje.



- 2.3 Përshkrimi i infrastrukturës hekurudhore duke përfshirë përshkrimin teknik hekurudhor dhe karakteristikat e infrastrukturës.
- 2.4 Alokimet e kapaciteteve duke përfshirë procedurat dhe kushtet e alokimit.
- 2.5 Shërbimet që përmbajnë përshkrimin dhe kushtet e shërbimeve që ofrohen nga menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duke përfshirë paketën minimale të qasjes, të objekteve të shërbimit dhe shfrytëzimin e shërbimeve ndihmëse dhe shtesë.
- 2.6 Tarifimi i Infrastrukturës që përmbajnë parimet për përcaktimin e pagesave, metodën e llogaritjes së pagesave dhe pagesat për shërbimet.

## Neni 5

### Përcaktimi i Pagesave të Infrastrukturës

1. **Menaxheri i infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët** duhet të rregullojë pagesat e infrastrukturës në përputhje me natyrën e shërbimit, kohën e shërbimit, cilësinë e binarëve të trenit, situatën e tregut dhe kostot, duke respektuar parimet e transparencës dhe jo-diskriminimit .
2. **Menaxherit të infrastrukturës në pronësi shtetërore për përdorim të përbashkët i nevoitet** , përveç kërkesave të paragrafit 1, miratimi nga Ministrisë përgjegjëse për çështjet hekurudhore në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse për ndërmarrjet publike, para dorëzimit të draft deklaratës së rrjetit të palë e interesit.

## Neni 6

### Procesi i konsultimit sipas nenit 58

1. Çdo menaxher i infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët duhet të dorëzojë Draft deklaratën e Rrjetit **në të njëjtën kohë** për të gjithë palët e interesuara për konsultim.
2. Çdo palë e interesuar ka të drejtë të paraqesë komentet e **veta brenda pesë (5) ditëve** kalendarike pas pranimit të Draft Deklaratës së Rrjetit tek menaxheri i infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët dhe tek Organi Rregullator i Tregut Hekurudhor.
3. Menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të organizojnë një takim me palët e interesuara **jo më vonë se shtatë (7) ditë kalendarike** pas afatit të fundit për pranimin e komenteve të përmendura në paragrafin 2, për të diskutuar komentet të ndryshme në Draft deklaratën e rrjetit.
4. Takimi duhet të mbahet nën mbikëqyrjen e Organit Rregullativ të Tregut Hekurudhor.
5. Organi Rregullativ i Tregut Hekurudhor është përgjegjës për të shkruar protokollin zyrtar të takimit, dhe shpërndarjen e protokollit **brenda dy (2) ditëve kalendarike**.

6. Palët e interesuara kanë të drejtë të kenë **pesë (5) ditë kalendarike shtesë** pas marrjes së protokollit zyrtar për komente të mëtejshme, pyetje dhe ankesa të cilat do të dërgohen direkt të Organi Rregullativ i Tregut Hekurudhor.
7. Pas konsultimi final me Organin Rregullator të Tregut në **pesë ditët e fundit (5) kalendarike të procesit të konsultimit** çdo menaxher i infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët duhet të përgatisë deklaratën përfundimtare Rrjetit.
8. Deklarata përfundimtare e Rrjetit duhet të publikohet jo më vonë se katër (4) muaj para afatit të fundit për dorëzimin e kërkesës për linjat e trenit.
9. Deklarata e Rrjetit duhet të publikohet në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.
10. Deklarata e Rrjetit duhet të publikohet në faqen e internetit të menaxherit të infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët dhe pastajë të njoftojë ARH-në që ta publikojë në web faqën e vetë.
11. Deklarata e Rrjetit duhet të freskohet në mënyrë të rregullt dhe tu dërgohet të gjithë palëve të interesuara.

#### **Neni 7**

#### **Roli i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave**

Pavarësisht nga procesi i konsultimit dhe gjatë vlefshmërisë së deklaratës së rrjetit Organi Rregullator i Tregut duhet të kontrollojë nëse Deklarata e Rrjetit përmban dispozita jo-transparente dhe / ose diskriminuese.

#### **Neni 8**

#### **Zbatimi**

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhor është kompetent për të kërkuar informacionin përkatës nga çdo palë e interesuar të përmendur në nenin 3. Informacioni duhet të sigurohet pa vonesë.

#### **Neni 9**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore duhet të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Halit Gara,  
Kryetar i Bordit  
Prishtinë, 16.01.2013

